



**Bizneset e Sektorit të
HoReCa-së/Gastronomisë
Para, Gjatë dhe Pas COVID-19**

në Kosovë
2020



Raporti hulumtues me rekomandime nga Instituti për
Ekonomi të Tregut të Lirë (IETLI)

Prëth nesh

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) është organizatë e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse e themeluar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), me seli në Prishtinë. Në përmbushjen e misionit të saj, Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë zhvillon hulumtime të besueshme me fokus në temat kryesore ekonomike në sektorin privat në Kosovë dhe i shfrytëzon rezultatet e hulumtimit për avokim, diskutim e debate publike për të ndikuar në krijimin e politikave më të mira për sektorin privat.



Ekipi ynë:

Hulumtim nga:

Besa Zogaj Gashi

Drejtoreshë Ekzekutive, IETL

besa.zogaj@ietl-oek.com

Viola Brahusi

Koordinatorë e projekteve, IETL

viola.brahusi@ietl-oek.com

Kontribues profesional:

Gent Sejdiu

Kryetar i Bordit të Drejtorëve, IETL

gent.sejdiu@ietl-oek.com

Shoqata e Gastronomeve të Prishtinës

[@Gastronometeprishtines](https://www.instagram.com/Gastronometeprishtines)

Dizajni dhe faqosja:

Tringa Hasbahta

tringahasbahta@gmail.com

Originali është shkruar në gjuhën shqipe

Publikuar nga:

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL)

Të drejtat e autorit ©2020 nga Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem për ripërdorim, apo të transmetohet në çfarëdo forme përmes çfarëdo mjeti, mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga publikuesi. Për kërkesa të tilla kontaktoni zyrën administrative të Institutit për Ekonomi të Tregut të Lirë.

Përmbajtja

Kapitulli i parë: Qëllimi dhe Objektivat	1
1.1 Hyrje	1
1.2 Qëllimi dhe objektivat	3
Kapitulli i dytë: Metodologjia e Hulumtimit	4
2.1 Metodologjia e hulumtimit	4
Kapitulli i tretë: Analiza dhe Prezantimi i të dhënave	5
3.1 Përmbledhje e gjetjeve kryesore	5
3.1.1 Të dhënat e përgjithshme mbi ndërmarrjet e anketuara të sektorit HoReCa	5
– Struktura e të anketuarve sipas segmenteve të sektorit	5
– Struktura e të anketuarve sipas gjinisë së pronarëve	5
– Struktura e të anketuarve, sipas shtrirjes hapësinore	5
– Viti i themelimit të ndërmarrjeve	5
3.1.2. Të dhënat specifike mbi ndërmarrjet e anketuara të sektorit HoReCa	5
– Perceptimi i ndikimit të pandemisë në qarkullimin mujor, krahasuar me vitin 2019 (të shprehura në Euro)	5
– Perceptimi i ndikimit të pandemisë në investimet e pronarëve në biznesin e tyre	6
– Ndikimi i pandemisë në obligimet ndaj furnitorëve	6
– Ndikimi i pandemisë në obligimet ndaj institucioneve financiare	6
– Ndikimi i pandemisë në obligimet ndaj qiradhënësve	7
– Perceptimi i ndikimit të pandemisë në punëtorët e tyre	7
– Perceptimet e bizneseve të HoReCa-së për lehtësimet e implementuara nga qeveria qendrore, lokale dhe bankat komerciale	8
– Perceptimi i ndikimit të pandemisë në falimentimin e bizneseve të tyre	8
Konkludime dhe Rekomandime	9
Literatura	11





Hyrje

Kapitulli 1.0 : Qëllimi & Objektivat

1.1

Më 13 Mars 2020, pas paraqitjes së dy rasteve të para të infektuar me koronavirus (Covid-19) në Kosovë, Qeveria e Kosovës ndërmoi një sërë veprimesh për distancim social që synuan të kufizojnë përhapjen e pandemisë në vend, ruajtjen e shëndetit dhe shpëtimin e jetëve të qytetarëve.

Përderisa në njërin anë, përpjekjet dhe vëmendja e gjithë shoqërisë me të drejtë është e orientuar në ruajtjen e shëndetit dhe shpëtimin e jetëve të qytetarëve, në anën tjetër kjo situatë prek direkt ekonominë reale, pra punësimin në sektorët realë të prodhimit dhe shërbimeve, me tendencën drejt krizës së qartë në të ardhmen. Mbetet të shpresojmë se kjo gjendje nuk do të zgjasë më shumë se deri në fund të 3-mujorit të dytë të këtij viti.

Në këtë periudhë duhet ndihmuar fort dhe thellësisht ekonomia, me vetëm një prioritet mbi të, shëndetin e popullatës. Kjo është një detyrë dhe përgjegjësi shumë e rëndësishme që i takon të gjithëve (Qeverisë Qendrore e Lokale, Bankës Qendrore, Autoriteteve Fiskale, Rregullatore dhe Mbikëqyrëse), të cilët mund të ndihmojnë në kontrollin e shpërthimit të virusit dhe të kompensojnë dëmin ekonomik të pandemisë.

Spektori i HoReCa-së/Gastronomisë¹ ka marrë goditjen më të rëndë duke u gjetur gjatë natës në një realitet

krejtësisht të ndryshëm, i cili do të ndodhet përpara një sfide të paparë si nga pikëpamja e shtrirjes dhe kohëzgjatjes ashtu dhe nga pikëpamja e ndikimit social-ekonomik që mund të sjellë pandemia. Bizneset e këtij sektori edhe në kohërat më të mira e kanë shumë të vështirë për të operuar e kjo gjendje e rëndë mund të keqësohet tutje nëse lakorja e virusit dhe mesatarja e infektiveve ditore shkon duke u rritur dhe nëse faza e dytë dhe tretë e hapjes së ekonomisë dhe heqja e kufizimeve shtyhet në rast se vlerësimi i situatës epidemiologjike rëndohet.

Humbjet llogariten të jenë të konsiderueshme për sektorin direkt, por edhe për sektorët e tjerë që në ndonjë mënyrë janë të ndërlidhur me këtë sektor. E vetmja formë e lejuar e një pjese të veprimtarisë ishte ofrimi i ushqimeve përmes shpërndarjes (delivery), siç deklaruan 2.3% e respondentëve, formë e cila për bizneset e tyre në këtë fazë ka sjellë një qarkullim simbolik monetar, mirëpo për bizneset e tilla të sigurojnë jetesën vetëm nga ofrimi i shërbimeve përmes shpërndarjes është shumë e vështirë.

Sidoqoftë, segmentet më të dëmtuara të industrisë HoReCa janë baret dhe klubet e natës/diskotekat si dhe sallat e dasmave që nuk kanë alternativa tjera të të bërit biznes.

Alarmin për krizën e sektorit HoReCa e ka vënë në dukje edhe Shoqata e Gastronomisë në Prishtinë, e cila vepron në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës.

¹ HoReCa është shkurtesë e fjalëve Hotel, Restaurants and Catering pra në gjuhë shqipe Hotel, Restorant dhe ofruet i shërbimeve dhe është një referencë për ofruet evropian të industrisë të akomodimit, ushqimit dhe pijeve. Po ashtu si term tjetër për këtë sektor përdoret termi Gastronomi i cili është një segment i industrisë të akomodimit dhe aktiviteteve të shërbimit të ushqimit dhe pijeve.

Para se epidemia e koronavirusit të arrinte në Kosovë, bazuar në të dhënat statistikore nga Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve² për vitin 2018 në sektorin HoReCa (akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim) ishin të regjistruara **3,683 ndër-marrje**, të shprehura në përqindje përbëjnë **10.40% të ekonomisë**. Ndërsa sa i përket punësimit, sektori HoReCa sipas burimit të njëjtë në vitin 2018 kishte 13,955 numrin total të punësuarve, apo të shprehur në përqindje 7.8%.

Këto të dhëna flasin për rëndësinë e sektorit në ekonominë e Republikës së Kosovës, duke shtuar faktin që ky sektor në të gjitha vendet e botës ballafaqohet me sfida të mëdha edhe në kohërat më të mira, duke e pasur shumë të vështirë për të operuar dhe përcjellë trendët për shkak të ndryshimit të preferencave të konsumatorëve, vendndodhjes së gabuar, menaxhmentit të dobët, shërbimit jo të duhur ndaj klientëve, stafi jo i trajnuar, mungesa e reklamimit dhe marketingut, mungesa e kapitalit për të investuar dhe faktor tjerë. Me të gjitha këto vështirësi, ky sektor është i qëndrueshëm dhe gjithnjë në rritje në Kosovë.

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL), aktualisht ka zhvilluar disa hulumtime përmes rrjeteve sociale (online), email-ave dhe intervistimit nëpërmes telefonatave (video konferenca) për disa sektor të ekonomisë me qëllim të vlerësimit të ndikimit negativ të virusit COVID-19 në sektorët specifik.

Ky hulumtim prezanton rezultatet e anketimit të sektorit HoReCa, para, gjatë dhe pas COVID-19 në Kosovë, përkatësisht ndikimin në: qarkullimin mujor dhe në likuiditet; në numrin e të punësuarave; në obligimet ndaj furnitorëve, institucioneve financiare dhe qiradhënësve; vlerësimet e bizneseve të anketuar për masat e Pakos Fiskale Emergjente.

Raporti hulumtues, përfshin po ashtu edhe disa rekomandime dhe masa të propozuara të nevojshme për menaxhimin e situatës, duke përfshirë edhe këndvështrimin e të anketuarve për masat e ndërmarra dhe masat tjera që duhet të ndërmerren më tutje nga Qeveria e Republikës së Kosovës për tejkalimin e situatës, të shmangin falimentimin dhe rifillojnë punën dhe kompensimin e dëmit ekonomik të pandemisë në këtë sektor.

“Bazuar në rezultatet e hulumtimit, situata e krijuar nga pandemia sipas 75.90% të bizneseve të anketuara në sektorin HoReCa në Kosovë do të detyrohen të shkojnë në falimentim nëse situata epidemiologjike dhe masat përcjellëse sidomos distanca sociale do të na përcjellë tutje në muajt e ardhshëm përgjatë vitit 2020.”

Rezultatet flasin për një “skenar të rastit më të keq” ku duke krahasuar qarkullimin mujor për periudhën e njëjtë të vitit 2020, 67.8% të anketuarve kanë deklaruar që kanë pasur rënie për 100% të qarkullimit të tyre mujor krahasuar me vitin 2019

Gjithashtu bazuar në rezultatet e hulumtimit tonë, kategoria më e dëmtuar janë punëtorët e tyre. Në përgjigjet e marra nga pyetja se sa punëtorë kanë pasur para muajit Mars, ka rezultuar që pjesa më e madhe e tyre kanë pasur 3 deri 15 punëtorë dhe 52.9% e tyre kanë deklaruar që janë detyruar t'i largojnë të gjithë punëtorët nga puna. Kur flasim për humbjen e vendeve të punës duhet marrë parasysh faktin se në këtë sektor kemi punëtor që punojnë pa kontrata pune (në informalitet), e cila do të jetë një goditje e rëndë në rritjen e papunësisë dhe varfërisë në Kosovë, që pas pandemisë do të jetë një ndër problemet më të mëdha në Kosovë.

E ardhmja e sektorit të HoReCa varet nga situata epidemiologjike dhe masat përcjellëse sidomos distanca sociale që do të na përcjellë për një kohë të gjatë, pa e anashkaluar dhe frikën psikologjike të qytetarëve që praktikisht do e pamundësojë mbledhjen e një numri të madh të njerëzve në një vend. Për të mbijetuar ky sektor i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, kërkohet një plan lehtësimi të synuar nga qeveria qendrore dhe ato lokale. IETL ka dhënë disa rekomandime për institucionet përgjegjëse përfshirë: mundësinë e kompensimit të dëmeve financiare; lehtësime tatimore, shtyrja e pagesave të taksave dhe kontributeve shoqërore; llogaritjen dhe mbulimin e borxheve nga kosto fikse dhe masat tjera ndihmëse për punëtorët dhe qiratë e tyre.


Studimi është ndërmarë për të fituar një pasqyrë preliminare të ndikimit të pandemisë COVID-19 dhe opinionet e paraqitura reflektojnë vetëm situatën fillestare (gjatë tetë javëve) dhe mund të mos reflektojnë drejtë zhvillimet e mëtejshme të shkaktuara nga pandemia. IETL do të jetë e përkushtuar edhe në periudhën pas pandemisë të vazhdojë me anketim, takime dhe monitorim me përfaqësuesit e sektorit të HoReCa-së dhe Shoqatën e Gastronomisë të avokuar dhe shfrytëzuar rezultatet e hulumtimit për nxitjen e debateve me palët me interes (qeveria qendrore e lokale) për marrjen e masave dhe zgjidhjen e alternativave për çdo situatë që mund të krijohet.

Qëllimi & Objektivat | 1.2

Studimi është ndërmarrë për të fituar një pasqyrë preliminare të ndikimit të pandemisë COVID-19 dhe opinionet e paraqitura reflektojnë vetëm situatën fillestare (gjatë tetë javëve) dhe mund të mos reflektojnë drejtë zhvillimet e mëtutjeshme të shkaktuara nga pandemia. IETL do të jetë e përkushtuar në periudhën gjatë dhe pas pandemisë duke vazhduar me anketime, takime dhe monitorim me përfaqësuesit e sektorit HoReCa dhe Shoqatën e Gastronomisë, për të avokuar dhe shfrytëzuar rezultatet e hulumtimit për të nxitur debate me palët me interes (qeverinë qendrore dhe lokale dhe akterët tjerë) për të marrë masa dhe gjetjen e zgjidhjeve alternative që të mbështesin sektorin HoReCa përgjatë çdo situatë që mund të krijohet në sektor.

Qëllimi specifik i këtij hulumtimi është:

1. Të vlerësohet ndikimi në qarkullimin e parasë; dëmet financiare, ndikimi në pagesat e obligimeve ndaj furnitorëve dhe obligimeve tjera kontraktuale (kredi) në sektorin HoReCa gjatë kësaj periudhe dhe në muajt në vijim;
2. Të vlerësohet ndikimi tek fuqia punëtore e këtij sektori;
3. Të vlerësohet se sa përfaqësuesit e sektorit të gastronomisë janë të kënaqur me vendimet e Qeverisë për masat kufizuese pas shpërthimit të pandemisë COVID-19 dhe vlerësimit të masave të vendosura nga Qeveria; dhe
4. Të propozohen disa rekomandime si masa të nevojshme që duhet ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe palëve të tjera me interes në këtë sektor për tejkalimin dhe stabilizimin e situatës, shmangies së falimentimit dhe rifillimit të punës.



Metodologjia e Hulumtimit

2.1


Kapitulli 2.0: Metodologjia e hulumtimit

Pyetësoni është dizajnuar për mbledhjen e informacioneve të përgjithshme për biznesin dhe iu është drejtuar në mënyrë selektive pronarëve të:

- Hoteleve;
- Moteleve;
- Restoranteve klasike (kuzhina të ndryshme tradicionale të specializuara);
- Bistro (ushqim dhe pije);
- Bareve (vetëm pije);
- Klubeve të natës/Diskoteka, dhe
- Fast food (sandwich bar, qebaptore, gjellëtore, Piza - Take Away).

Anketa ka qenë publike, targetimi i respondentëve që janë përgjigjur anketës është bërë përmes rrjeteve sociale (online), email-ave dhe intervistimit nëpërmes telefonatave (video konferenca), në bashkëpunim me Shoqatën e Gastronomisë në Prishtinë.

Hulumtimi përfshin të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me një numër të përgjithshëm të respondentëve prej 192 bizneseve që u janë përgjigjur anketës. Rezultatet nga anketa janë paraqitur në vijim të këtij raporti në formë të shkruar dhe grafike.



Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Kapitulli 3.0 :
Analiza dhe Prezantimi i të dhënave

3.1

3.1.1

Të dhënat e përgjithshme mbi ndërmarrjet e anketuara të sektorit HoReCa

Struktura e të anketuarve sipas segmenteve të sektorit

Struktura e pjesëmarrësve që janë pjesë e hulumtimit është si në vijim:

41.4% e ndërmarrjeve të cilët kanë marrë pjesë në anketim janë deklaruar si ndërmarrje nga segmenti Bistro (ushqim dhe pije);

18.4% nga segmenti i Bareve (vetëm pije) dhe Restoranteve Klasike (kuzhina të ndryshme tradicionale dhe specializuara),

8.0% nga segmenti i Fast Food (Sandwich Bar, Qebaptorë, Gjellëtore, Pizza-Take Away),

6.9% nga segmenti i Hotelarisë si dhe;

6.9% janë Klub Nate/Diskoteka

Struktura e të anketuarve sipas gjinisë së pronarëve

Ndërkaq sa i përket strukturës gjinore: 90.8% të pronarëve të anketuar janë të gjinisë mashkullore ndërkaq 9.2% janë të gjinisë femërore.

♂ 90.8% **♀ 9.2%**

Përballë panikut të përgjithshëm për shëndetin publik ankthi i mbijetesës ka ndikuar edhe në bizneset e grave në Kosovë që statistikisht veçse gjenden në numër të vogël dhe në disavantazh në ambientin e të bërit biznes në Kosovë në krahasim me burrat.


Struktura e të anketuarve, sipas shtrirjes hapësinore

Shikuar nga aspekti i shtrirjes gjeografike, rreth 74.7% e të anketuarve janë nga Komuna e Prishtinës, përqindja tjetër shpërndahet në komuna tjera. Arsyeja pse pjesa më e madhe e anketuesve kanë marrë pjesë nga Prishtina është numri më i madh i bizneseve të këtij sektori që operojnë në Komunën e Prishtinës për shkak

të koncentrimit të madh të popullsisë.

Viti i themelimit të ndërmarrjeve

Sipas të dhënave të prezantuara në Grafikon nr. 1, mund të vërejmë se mbi 39.1% e respondentëve ushtrojnë veprimtarinë e tyre për më shumë se 10 vite. Bizneset e këtij sektori edhe në kohërat më të mira e kanë shumë të vështirë për të operuar, për shkak të ndryshimit të preferencave të konsumatorëve, vendndodhjes së gabuar, menaxhmentit të dobët, stafit jo të trajnuar, mungesës së reklamimit dhe marketingut, mungesën e kapitalit për të investuar dhe faktor tjerë, mirëpo edhe përkundër të gjitha vështirësive, kjo e dhënë nënkupton që këto biznese të sektorit HoReCa janë biznese mjaft të qëndrueshme në Kosovë ku si mesatare e viteve të veprimtarisë së tyre është 5 e më shumë vite.




Grafiku 1

3.1.2

Të dhënat specifike mbi ndërmarrjet e anketuara të sektorit HoReCa

Perceptimi i ndikimit të pandemisë në qarkullimin mujor, krahasuar me vitin 2019 (të shprehura në Euro)

Nëse e krahasojmë qarkullimin mesatar mujor me vitin e kaluar (2019), rreth 16.1% e respondentëve u deklaruan se kanë pasur qarkullim mesatarisht 10,000 deri në 15,000 Euro, ndërsa 13.8% e tyre prej 15,000-20,000 Euro (për më shumë shiko Grafikon nr.2).



Grafiku 2

Rezultatet e hulumtimit flasin se 67.8% të anketuarve kanë deklaruar se qarkullimi i tyre mujor ka pasur rënie për 100% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar .

67.8% ↓ -100% të qarkullimit mujor

“97.7% e respondentëve u deklaruarën se nuk kanë mundësi të ushtrjnë veprimtarinë tyre, ndërsa vetëm 2.3% e tyre kanë shfrytëzuar të vetmen formë të lejuar të veprimtarisë që ishte ofrimi i ushqimeve përmes shpërndarjes (delivery)...”

...i cili deri më tani ka qenë një burim i të ardhurave, dhe do të jetë e vështirë për bizneset e tilla të sigurojnë jetesën vetëm nga ofrimi i shërbimeve përmes shpërndarjes.

Nga këto të dhëna, mund të konkludohet se kjo situatë rëndon 97.7% të bizneseve të sektorit për arsye se natyra e punës së tyre dallon dhe nuk mund të funksionojnë në këto kanale shitjesh. Segmentet më të dëmtuara të industrisë së HoReCa janë baret dhe klubet e natës/diskotekat si dhe sallat e dasmave që nuk kanë alternativa tjera të të bërit biznes.

Perceptimi i ndikimit të pandemisë në investimet e pronarëve në biznesin e tyre

Kriza aktuale, nga pandemia COVID-19, ka prekur të gjitha investimet, gjithashtu edhe investimet e pronarëve në sektorin HoReCa, ku **96.6% e të anketuarve deklaruan se kanë ndaluar së investuari për tu përgatitur për vitin 2020**, më konkretisht për sezonin pranver-or-veror për shkak të përhapjes së pandemisë.

Ndikimi i pandemisë në obligimet ndaj furnitorëve

Pronarët e bizneseve të anketuara kanë deklaruar që kanë obligime financiare për të paguar.

Prej tyre **75.9% kanë obligim ndaj furnitorëve**. Sipas tyre borxhet janë shumë shqetësuese dhe dëshmojnë një problem serioz për bizneset e tyre. Qeveria e Kosovës nga 180 milionë euro të Pakos Fiskale Emergjente për biznese të cilat janë duke u ballafaquar me probleme ekonomike pas shpërthimit të pandemisë së Koronavirusit, ka ndarë një shumë të hollash për sigurimin e likuiditetit financiar të kompanive (Masa 10-Sigurimi i likuiditetit financiar)³ .



Ndikimi i pandemisë në obligimet ndaj institucioneve financiare

75.9% e bizneseve të anketuara kanë kredi për të rritur kapacitetin e bizneseve, të cilët në fund të muajit nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme financiare për të paguar këstin e kredisë, për shkak të mbylljes së përkohshme të bizneseve të tyre dhe mungesës së likuiditetit të biznesit. Ndërprerja dhe ngadalësimi i aktivitetit të bizneseve ka ndikuar në aftësinë paguese të tyre.

Banka Qendrore e Kosovës së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës kanë vendosur bashkarisht që për bizneset dhe individët të cilët për shkak të gjendjes së krijuar në vend dhe rënies së nivelit të të hyrave të tyre, të ju mundësohet pezullimi i pagesave të kësteve të kredisë, nga data 16 mars 2020 deri me 30 prill 2020 dhe varësisht nga situata, ky pezullim të shqyrtohet edhe për më gjatë.⁴

3 Burimi: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/CF860B38-765C-41B3-87D0-6E38AD371584.pdf>

4 Burimi: <https://www.bqk-kos.org/?id=104&l=1726>

87.4% e anketuesve të cilët u shprehën që do e kenë të vështirë të paguajnë këstet e tyre mujore ndaj institucioneve financiare, nëse ky mos funksionim i bizneseve të tyre do vazhdojë përgjatë muajve të ardhshëm. Kjo do të ndikoj në rritjen e kërkesave për shtyrje të kësteve të kredisë. Duke vlerësuar situatën reale, sigurisht se efektet do të shtrihen përtej periudhës tremujore të parashikuar. Në këtë aspekt qeveria duhet të ndihmojë në stabilizimin e gjendjes dhe koordinimin e aktiviteteve të kontraktuara me furnitorët dhe institucionet kredi dhënëse.

Ndikimi i pandemisë në obligimet ndaj qiradhënësve

Rreth 83.9% e bizneseve të anketuara ushtrojnë vepërimtarinë e tyre biznesore në objekte me qira.

83.9% Pronë me qira

16.1% Pronë personale

Mesatarja e qirasë mujore (sipas rezultateve të anketës) është e ndryshme duke shkuar mesatarisht mbi 450-650 euro në muaj e më shumë.

“Nga Pakoja Fiskale Emergjente, Qeveria e Kosovës ka ndarë 12 milionë euro subvencion për pagesat e qirave për 2 muaj për bizneset private”


(Masa 3b - Subvencioni i qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme).⁵

Ndërkaq Komuna e Prishtinës ka përgatitë një pako ekonomike emergjente që përmban 14 pika, ndër të cilat është edhe pika për lirimin e bizneseve nga qiraja për dy muaj, kurse bizneset e gastronomisë që paguajnë për terasat do të lirohen nga pagesa për një vit.⁶



Perceptimi i ndikimit të pandemisë në punëtorët e tyre

Kategoria më e dëmtuar e këtij sektori janë punëtorët e tyre. Pamundësia e bizneseve për të ushtruar aktivitetin e tyre në mënyrë normale ka ndikuar në punësimin dhe të ardhurat e punëtorëve. Ne përgjigjet e marra nga pyetja se sa punëtorë kanë pasur bizneset para muajit Mars, ka rezultuar që 16.1% e tyre kanë pasur të punësuar 5-7 punëtorë, ndërsa 14.9% kanë pasur të punësuar 3 deri 5 punëtorë (për më shumë shiko Grafikon nr. 3).



Grafiku 3

Kosova ka një shkallë të lartë të papunësisë prej 30%, ky numër pritet të jetë shumë i madh kur të shtohet edhe punëtorët e larguar nga ky sektor. Bizneset e anketuara, 52.9% e tyre kanë deklaruar që janë detyruar t'i largojnë të gjithë punëtorët nga puna.

52.9% larguan të gjithë punëtorët

27.6% larguan 1-2 punëtorë
10.3% larguan 3-5 punëtorë
9.2% larguan 2-3 punëtorë

Një nga masat e Pakos Fiskale Emergjente ka paraparë punëtorët të cilët do të përfitojnë nga 170 euro për pagat e muajit Mars dhe Prill 2020. Mirëpo marrë parasysh se në Kosovë në këtë sektor kemi punëtorë që punojnë pa kontratë pune (informalitet) iu është dhënë mundësia të përfitojnë nga kjo masë ndihmëse, nëse punëdhënësit e tyre do i regjistrojnë ata si punëtorë të ndërmarrjes së tyre.

Të gjitha këto kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rënien e konsumit dhe ulje të rritjes ekonomike nga -2 deri në -4 përqind.⁷

Ndërkaq, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, pas pandemisë, ekonomia e Kosovës pritet të tkurret për 5 përqind.⁸

5 Burimi: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/CF860B38-765C-41B3-87D0-6E38AD371584.pdf>

6 Burimi: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/wp-content/uploads/sites/45/2020/04/1.Vendim-pako-ekonomike-emergjente.pdf>

7 Sipas parashikimeve edhe të Bankës Qendrore të Kosovës do të ketë një ulje të rritjes ekonomike nga -2 deri në -4 përqind (Burimi: <https://bqk-kos.org/index.php?id=104&l=1731>).

8 Burimi: <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/04/10/pr20149-kosovo-imf-executive-board-approves-us-million-emergency-support-address-covid-19-pandemic>

Perceptimet e bizneseve të HoReCa-së për lehtësimet e implementuara nga qeveria qendrore, lokale dhe bankat komerciale


83.9% e të anketuarve kanë deklaruar që kanë aplikuar për ndonjë nga masat e Pakos Fiskale Emergjente të implementuara nga qeveria qendrore dhe lokale, ndërsa nga 16.1% e të anketuarve nuk kanë aplikuar në këto masa, pasi që shumica (45.2% e tyre) konsiderojnë që këto masa duhet të jenë më stimuluese.

(Për më shumë, shiko Grafikon nr. 4)

Nga masat e aplikuara nga qeveria qendrore dhe lokale:

83.9% e kanë konsideruar Masën 3A: Mbulimi i pagave të punëtorëve në vlerë prej 170 Euro për muajin Prill dhe Maj 2020.

71.3% për Masën 3B: Subvencionim i qirasë deri 50% për muajin Prill dhe Maj 2020, si masa më efektive për qëndrueshmërinë e biznesit të tyre gjatë kësaj periudhe të vështirë ekonomike të shkaktuar nga përhapja e pandemisë.



Grafiku 4

“Sa i përket lehtësimeve në shtyrjen e pagesave të kësteve mujore të implementuara nga bankat komerciale dhe institucionet financiare, **55.2%** e të anketuarve kanë deklaruar që këto lehtësime nuk ju ndihmojnë aspak.”

37.9% deklaruan se mjaftueshëm ju ndihmojnë
6.9% deklaruan se shumë ju ndihmojnë

Perceptimi i ndikimit të pandemisë në falimentimin e bizneseve të tyre

Nëse situata aktuale me masat kufizuese do vazhdojë për shkak të pandemisë COVID-19 edhe me shumë se 3 muajt e ardhshëm, **75.3%** e pronarëve të bizneseve të anketuara nuk shpresojnë që do të kenë mundësi të mbijetojnë nga kriza financiare dhe do të detyrohen të aplikojnë për procedurat e falimentimit.



Konkludime & Rekomandime

Sektori HoReCa ka marrë goditjen më të rëndë nga pandemia COVID-19. Kjo gjendje e rëndë mund të keqësohet tutje nëse lakorja e virusit dhe mesatarja e infektiveve ditore shkon duke u rritur dhe nëse faza e dytë dhe tretë e hapjes së ekonomisë dhe heqja e kufizimeve shtyhet në rast se situata rëndohet.

E ardhmja e sektorit të HoReCa varet nga situata epidemiologjike dhe masat përcjellëse sidomos distanca sociale që do të na përcjellë për një kohë të gjatë, pa e anashkaluar dhe frikën psikologjike të qytetarëve që praktikisht do e pamundësojë mbledhjen e një numri të madh të njerëzve në një vend. Për të mbijetuar ky sektor i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, kërkohet një plan lehtësimi të synuar nga qeveria qendrore dhe ato lokale.

Hulumtimi ynë ofron në vazhdim disa konkludime dhe masa që do duhej ndërmarrë Qeveria e Kosovës me palët tjera me interes, për stabilizimin dhe rimëkëmbjen e sektorit.

Konkludime

1. 97.7% e respondentëve u deklaruan se nuk kanë mundësi të ushtrojnë veprimtarinë tyre, ndërsa vetëm 2.3% e tyre kanë shfrytëzuar të vetmen formë të lejuar të veprimtarisë përmes shpërndarjes (Delivery).
2. Segmentet më të dëmtuara të industrisë HoReCa janë Baret dhe Klubet e natës/Diskotekat si dhe Sallat e Dasmave që nuk kanë alternativa tjera të të bërit biznes.
3. 75.3% të bizneseve të anketuara në sektorin HoReCa në Kosovë do të detyrohen të shkojnë në falimentim nëse situata epidemiologjike dhe masat përcjellëse do të vazhdojnë tutje në muajt e ardhshëm përgjatë vitit 2020.
4. 67.8% të anketuarve kanë deklaruar që kanë pasur rënie për 100% të qarkullimit të tyre mujor krahasuar me vitin 2019, dmth kanë vështirësi në likuiditet.
5. 52.9% e tyre kanë deklaruar që janë detyruar t'i largojnë të gjithë punëtorët nga puna.
6. 9.2% e bizneseve të anketuara janë në pronësi të grave, të cilat janë duke u ballafaquar me prob-

leme të mëdha financiare gjatë kësaj faze, e cila kategori edhe në rrethana normale sipas statistikave gjenden në numër të vogël (krahasuar me të gjitha vendet tjera të rajonit dhe më gjerë) dhe në disavantazh në ambientin e të bërit biznes në Kosovë në krahasim me bizneset në pronësi të burrave.

7. 75.9% e bizneseve të anketuara kanë obligime financiare ndaj furnitorëve dhe institucioneve financiare.
8. 87.4% e bizneseve të anketuara kanë kredi, të cilët në fund të muajit nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme financiare për të paguar këstin e kredisë.
9. Rreth 83.9% e bizneseve të anketuara ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznese në objekte me qira. Mesatarja e qirasë mujore është e ndryshme, mesatarisht prej 450-650 Euro në muaj e më shumë (në Komunën e Prishtinës është më e madhe).
10. Bizneset e sektorit të HoReCa para pandemisë ishin biznese mjaft të qëndrueshme në Kosovë, ku 39.1% e të anketuarve kanë deklaruar që ushtrojnë biznesin e tyre për më se 10 vite.
11. 83.9% e të anketuarve kanë deklaruar që kanë aplikuar për ndonjë nga masat e Pakos Fiskale Emergjente të implementuara nga Qeveria Qendrore dhe Lokale dhe e kanë vlerësuar si shumë pozitive.

Pasojat e dëmtimit të sektorit të HoReCa dhe efektet e tyre anësore:

- Rënia e Bruto Produktit Vendor (BPV).
- Rënia e të hyrave buxhetore, që vijnë nga sektori.
- Rritja e papunësisë.
- Dëmtimi në sektorët tjerë dhe në tërë ekonominë.
- Mungesa e likuiditetit të bizneseve të sektorit HoReCa, mund të ndikoj në rritjen e kredive jopërfomuese në sektorin financiar.
- Komuna e cila është goditur më së shumti nga efektet negative të pandemisë COVID-19 në sektorin e HoReCa është Prishtina, për shkak të koncentrimit më të madh të bizneseve të këtij sektori në Prishtinë.

Rekomandime

IETL ofron disa rekomandime për qeverinë në pakon tjetër të ndërhyrjes, për të cilat sugjerojmë që të përqendrohet vëmendja në masat si mëposhtë dhe të merren parasysh si bazë e nxitjes së dialogut të më-tutjeshëm:

Të ruhet aftësia paguese e bizneseve të sektorit HoReCa për të siguruar pagat e punëtorëve

- Të vazhdohen masat për lirime nga tatimet dhe subvencione për punëtorë, për bizneset që i përka-sin sektorit të HoReCa.
- Më tepër përkujdesje për evidentimin dhe ndih-mesën ndaj të punësuarve pa kontratë (në të zezë). Marrë parasysh se në Kosovë në këtë sek-tor kemi punëtorë që punojnë pa kontratë pune (informalitet), për këtë iu është dhënë mundësia të përfitojnë nga Masat Ndhimesë të Qeverisë, që punëdhënësit e tyre t'i regjistrojnë ata si punëtorë me kontratë.

Përkrahje për sigurimin e likuiditetit financiar

- Subvencione të drejtpërdrejta për bizneset e sek-torit me kritere më të lehta për kualifikim.
- Masa 10 A, të ketë lehtësime më të mëdha në kri-tere gjatë kësaj periudhe të rimëkëmbjes, si p.sh. (ka shumë biznese që kanë më pak se 10 punëtorë, të ulet kriteri më poshtë; ka biznese që kanë pasur vështirësi të mëparshme në pagesa dhe marrje të kredive, të iu lehtësohen kriteret e kredimarrjes, të mos merret parasysh historia kreditore.
- Subvencionim i një pjese të huamarrjes aktuale nga qeveria: Huamarrësit e biznesit të vogël të subvencionohen për pjesën e huamarrjes të tyre që e kanë përdorur për kompensimin e punonjësve dhe disa kosto të tjera të mirëmbajtjes së biznesit gjatë kohës që nuk e ushtrojnë aktivitetin e tyre për shkak masave që janë marrur ose mirren me tutje nga qeveria për parandalimin e pandemisë të virusit COVID-19. Në mënyrë të veçantë, shu-ma e subvencionim është ajo që huamarrësi ka shpenzuar për pagat, detyrimet e kredi marrjes dhe qirasë dhe kostot e shërbimeve (faturat e rry-mës, ujit, mbeturinave, telefonisë dhe mirëmbajtjes së objektit ku e ushtrojnë veprimtarinë).

- Të themelohet një program i subvencioneve të veçanta që ta ndihmojnë rimëkëmbjen me fokus të veçantë për segmentet më të dëmtuara të sek-torit të HoReCa siç janë: baret, klubet e natës/ diskotekat dhe sallat e dasmave, të cilët do të bal-lafaqohen tutje me masa kufizuese edhe me peri-udhë më të gjatë kohore. Ndërkaq natyra e tyre e punës koncentrohet në 3 muajt e sezonit verore (Qershor, Korrik, Gusht).

Të bëhen lirime tatimore

- Të vazhdoj masa e shtyrjes së afateve të deklarimit të tatimit.
- Ulja e TVSH-së për sektorin e HoReCa për të stim-ular rimëkëmbjen e bizneseve, në mënyrë që bi-zneset të rifillojë punën sa më shpejt që të jetë e mundur, kur kërcënimi i pandemisë të zvogëlohet.

Të vazhdohet me subvencionim të qirasë edhe në muajt e ardhshëm për qiramarrësit.

- Vazhdimi i subvencionimit të qirasë edhe në muajt e ardhshëm për qiramarrësit.
- Të bëhet një akt nënligjor apo marrëveshje tri palëshe në mes: qiradhënësit, qiramarrësit dhe qeverisë qendrore me qëllim të mbrojtjes së qira-marrësve nga evakuimi prej pronës dhe limitimin e ngritjes së çmimit të qirasë deri në stabilizimin e situatës së krijuar nga kriza e pandemisë të virusit COVID-19.

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të jap garanci afatshkurte dhe afatgjate, sinjale pozitive dhe trans-parente, të rialokojë fonde dhe të orientojë si duhet ekonominë.

“Promovimi i rimëkëmbjes do të ketë sfidat dhe sakrificat e veta, duke përfshirë nivele më të larta të borxhit publik dhe ndoshta pjesë të sektorëve të ekonomisë do të vihen nën kon-trollin e përkohshëm të qeverisë. Por **suksesi relativ në këtë fazë do të sigurojë që ekonomia të mund të kthehet në funksionimin e saj normal.”**

Literatura



1. Anketa e drejtuar për bizneset që i përkasin sektorit HoReCa:
https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLScdMJX-rqjiNuCOvKFXnADI0x2VMSG0Pc5r_OmCL4O9fEXT-Fyw/viewform
2. Banka Qendrore e Kosovës (BQK):
<https://www.bqk-kos.org/>
3. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK):
<https://ask.rks-gov.net/>
4. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), selia në Kosovë:
<https://www.imf.org/en/Countries/UVK>
5. Ministria e Financave dhe Transfereve, vendimi për miratimin e Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente:
<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/CF860B38-765C-41B3-87D0-6E38AD371584.pdf>
6. Komuna e Prishtinës, vendimi për miratimin e Pakos Ekonomike Emergjente:
<https://kk.rks-gov.net/prishtine/wp-content/uploads/sites/45/2020/04/1.Vendim-pako-ekonomike-emergjente.pdf>
7. Konsultimet e vazhdueshme me akterët tjerë kryesorë